

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

## **SKELETKURRIKULI**

**Për kualifikimin**

# **INSTRUKTOR NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL**

**Niveli V i KSHK**  
**(Pas të mesmes)**

**Kodi: XA1-V-14**

Miratoi:

.....

**Ky skeletkurrikul u hartua me mbështetjen e Projektit IPA 2010 për  
Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, financuar nga Bashkimi Evropian dhe  
zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës.**



**Tiranë, 2014**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

**II. Profili profesional i pjesëmarrësve në kualifikimin për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

1. Kërkesat e pranimi të pjesëmarrësve në kualifikimin për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.
2. Kompetencat profesionale të pjesëmarrësve në përfundim të kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.
3. Mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm të pjesëmarrësve në përfundim të kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.

**III. Plani mësimor i kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor**

**V. Udhëzime për procesin e kualifikimit.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i SHK.**

**VIII. Modulet mësimore për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

**IX. Udhëzime për Praktikën e grupuar në një ofrues të AFP**

## **I. Qëllimet e kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

Qëllimi kryesor i kualifikimit në profilin për Instruktor në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP), niveli V i KSHK, është *“aftësimi i pjesëmarrësve me kompetencat e nevojshme për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen me mësimdhënien në sektorin e arsimit dhe formimit profesional”*. Për të realizuar këtë, ofruesi i këtij kualifikimi profesional u krijon pjesëmarrësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt të nxënësve më të mirë;
- mbështetje për t’u njohur me metodologjitë dhe teknologjitë bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me këtë kualifikim profesional;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i pjesëmarrësve në kualifikimin për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

### **1. Kërkesat e pranimit të pjesëmarrësve në kualifikimin për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

Për të ndjekur kualifikimin për “Instruktor në AFP”, niv. V i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë dhe të rriturit që:

- kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional;
- kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe kanë kryer kurse formimi në një profesion.
- kanë jo më pak se 3 vite përvojë pune në një profesion;

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë kualifikim janë më të larta se kapacitetet reale të ofruesit, përgatiten kritere të posaçme pranimi.

### **2. Kompetencat profesionale të pjesëmarrësve në përfundim të kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

Në përfundim të kualifikimit për “Instruktor në AFP”, niv. V i KSHK, pjesëmarrësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale, si më poshtë:

- Harton dokumente kurrikulare që lidhen me mësimin në AFP.
- Zbaton parimet bazë të didaktikës në AFP.
- Harton objektiva mësimore
- Përcakton përmbajtje mësimore në përputhje me objektivat mësimore.
- Përzgjedh dhe zbaton metoda të përshtatshme mësimore
- Përgatit instrumente dhe kryen vlerësime të nxënësve dhe kursantëve për aspektet teorike dhe praktike.

- Kryen demonstrime të shprehive praktike për proceset dhe produktet e punës.
- Përgatit mjedisin, mediet dhe materialet mësimore
- Përdor mjetet e ndryshme didaktike në mbështetje të procesit mësimor.
- Planifikon dhe realizon mësimet teorike
- Planifikon dhe realizon mësimet praktike
- Plotëson dokumentacionin zyrtar që lidhet me procesin mësimor në ofruesit e AFP
- Mirëmban mjedisin dhe mjetet e punës.
- Mbështet zhvillimin e njohurive, shprehive dhe qëndrimeve profesionale të nxënësve dhe kursantëve.
- Komunikon me etikë profesionale.
- Motivon dhe nxit pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe kursantëve në procesin mësimor.
- Përshtat procesin mësimor në përputhje me veçoritë psikologjike dhe fiziologjike të nxënësve dhe kursantëve.
- Angazhohet aktivisht në zhvillimin e tij profesional si instruktor dhe si profesionist.
- Kryen me korrektësi detyrat e ndryshme në kontekstin profesional.
- Tregon vetëkontroll dhe menaxhon situatat konfliktuale gjatë procesit mësimor.
- Bashkëpunon me kolegët dhe stafin menaxhues të ofruesve të AFP.
- Zbaton parimet e barazisë gjinore, etnike dhe racore.
- Zbaton legjislacionin që vepron në AFP

### **3. Mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm të pjesëmarrësve në përfundim të kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

Përfundimi me sukses i kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK, i mundëson pjesëmarrësve punësimin si instruktor në shkolla profesionale publike dhe jopublike, qendra të formimit profesional publik dhe jopublik, biznese që kryejnë kualifikim profesional të stafit të tyre, si dhe subjekte të tjera që ofrojnë kualifikime profesionale.

Pjesëmarrësit në kualifikimin për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK, mund të vijojnë kualifikimin e mëtejshëm në arsimin e lartë si dhe kualifikimin e vazhdueshëm për këtë veprimtari profesionale.

### **III. Plani mësimor i kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

<b>Plani mësimor kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.</b>			
<b>Nr</b>	<b>Kodi</b>	<b>Elementet kurrikulare</b>	<b>Orët vjetore</b>
<b>A.</b>		<b>Modulet mësimore teorike-praktike (Gjithsej)</b>	<b>540 orë</b>
1	M-27-1046-14	Hyrje në profesionin e instruktorit në AFP	30
2	M-27-1047-14	Hyrje në psikologjinë e të nxënësve	30
3	M-27-1048-14	Kurrikula në AFP	60
4	M-27-1049-14	Bazat e procesit mësimor në AFP	90
5	M-27-1050-14	Vlerësimi i nxënësve dhe kursantëve në AFP	90
6	M-27-1051-14	Planifikimi dhe realizimi i mësimit në AFP	240
<b>B.</b>		<b>Praktika e grupuar në një ofrues të AFP (Gjithsej)</b>	<b>450 orë</b>

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK, është 1 vit shkollor (990 orë mësimore).

Viti shkollor ka gjithsej 35 javë (18 javë mësimore + 15 javë praktikë e grupuar në një ofrues të AFP + 2 javë provimet përfundimtare teorike dhe praktike).

Një javë mësimore ka 30 orë mësimore teorike dhe/ose praktike (5 ditë x 6 orë/ditë).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Praktika e grupuar në një ofrues të AFP realizohet në periudhën e fundit të vitit shkollor me këtë kohëzgjatje: 15 javë x 5 ditë/javë x 6 orë/ditë = 450 orë.

Kurrikuli i kualifikimit për “Instruktor në AFP”, niv. V i KSHK, përbëhet nga 2 grupe elementesh kurrikulare:

- Modulet mësimore teorike-praktike (përshkruarit e tyre tregohen në rubrikën VIII të këtij skeletkurrikuli).
- Praktika e grupuar në një ofrues të AFP (kjo praktikë kryhet në përputhje me udhëzimet e përfshira në rubrikën IX të këtij skeletkurrikuli).

#### V. Udhëzime për procesin e kualifikimit.

Lektorët dhe moderatorët e kualifikimit për “Instruktor në AFP”, niv. V i KSHK, duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të pjesmarrësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të plota dhe të qëndrueshme si instruktor në AFP..

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes dhe formimi paraprak i pjesmarrësve, objektivat dhe përmbajtja e hollësishme e moduleve teorike – praktike të parashikuara, mundësitë reale që ka ofruesi i këtij kualifikimi për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të ofruesit të kualifikimit.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxënësit, është *motivimi i pjesmarrësve*. Njohja e vazhdueshme e pjesmarrësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga lektorët dhe moderatorët kualifikimit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit të instruktorit në AFP. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë hapësirë të konsiderueshme në procesin e kualifikimit.

Lektorët dhe moderatorët duhet të përdorin forma dhe metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehjet praktike të pjesmarrësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me detyra e studime rasti* duhet të jenë format bazë të organizimit të kualifikimit, veçanërisht të pjesës praktike të tij, për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale si instruktor, në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet zbatuar nga lektorët dhe moderatorët e kualifikimit është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e ofruesit të kualifikimit, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e

detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e pjesmarrësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si instruktorë të ardhshëm në AFP.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

Vlerësimi i vazhduar i pjesmarrësve në modulet teorike-praktike bëhet nga lektorët dhe moderatorët e seancave mësimore, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura dhe të përzgjedhura nga vetë ata.

Vlerësimi i pjesmarrësve bëhet me nota (4 - 10) si për modulet teorike-praktike, ashtu edhe në provimet përfundimtare. Nota minimale për kalim është nota 5.

Pjesmarrësit vlerësohen me notë për çdo modul mësimor, notë e cila llogaritet si mesatare e notave të fituara në secilin rezultat mësimor të modulit përkatës.

Për vlerësimin e pjesmarrësve në lidhje me aspektet teorike rekomandohen instrumente vlerësimi të tilla si pyetje përgjigje me gojë, testi me shkrim dhe bashkëbisedimi, ndërsa në lidhje me aspektet praktike rekomandohen lista e kontrollit dhe portofoli.

Vlerësimi i çdo pjesmarrësi në lidhje me shkallën e përmbushjes së detyrave gjatë praktikës së grupuar bëhet nga mentori përkatës, me anë të një përshkrimi me shkrim ku evidentohen arritjet dhe vështirësitë e çfaqura, si dhe jepet opinioni i mentorit nëse pjesmarrësi duhet të futet në provimet përfundimtare.

Në përfundim të kualifikimit për “Instruktor në AFP”, niv. V i KSHK, pjesmarrësit i nënshtrohen provimeve të mëposhtme:

a) Provimi teorik me shkrim (ku integrohen aspektet teorike të moduleve të kualifikimit);

b) Provimi praktik (ku pjesmarrësi demonstroi një seancë mësimore teorike-praktike).

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale të nevojshme për të punuar si Instruktor në AFP

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të kualifikimit për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.**

Me përfundimin e suksesshëm të kualifikimit për “Instruktor në AFP”, niv. V i KSHK, ofruesi i këtij kualifikimi e pajis pjesmarrësin me certifikatën përkatëse e cila përmban:

a) Të dhënat për pjesmarrësin, ofruesin e kualifikimit, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.

b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga pjesmarrësi:

- rezultatet në modulet profesionale;

- rezultatet në praktikën e grupuar;

- rezultatet e dy provimeve përfundimtare.

## VIII. Modulet mësimore për Instruktor në AFP, niv. V i KSHK.

### 1. Moduli “Hyrje në profesionin e instruktorit në AFP”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe Kodi i Modullit</b>	<b>HYRJE NE PROFESIONIN E INSTRUKTORIT NE AFP</b>	<b>M-27-1046-14</b>
<b>Emërtimi dhe Niveli i Kualifikimit</b>	<b>Instruktor në Arsimin dhe Formimin Profesional</b>	<b>Niveli V i KSHK</b>
<b>Kohëzgjatja e Modullit</b>	<b>30 orë mësimore</b>	
<b>Rezultatet e të Mësuarit (RM)</b>	<p><b>RM1:</b> Pjesmarrësi përshkruan veçoritë e profesionit të instruktorit në AFP.</p> <p><b>RM2:</b> Pjesmarrësi analizon veçoritë e sistemit të AFP.</p> <p><b>RM3:</b> Pjesmarrësi analizon konceptet bazë të AFP të bazuar te kompetencat.</p> <p><b>RM4:</b> Pjesmarrësi përshkruan kuadrin ligjor dhe institucional të AFP në Shqipëri.</p>	
<b>RM1</b>	<p><b>Pjesmarrësi përshkruan veçoritë e profesionit të instruktorit në AFP.</b>  <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Statusi i instruktorit të AFP.</li> <li>• Mundësitë e punësimit dhe të karrierës së instruktorit të AFP.</li> <li>• Konteksti dhe mjedisi i punës i instruktorit të AFP.</li> <li>• Detyrat dhe funksionet e instruktorit të AFP.</li> <li>• Kërkesat për instruktorin e AFP.</li> <li>• Kuadri ligjor për ushtrimin e profesionit të instruktorit të AFP.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me profesionin e instruktorit në AFP</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblendhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>	
<b>RM2</b>	<p><b>Pjesmarrësi analizon veçoritë e sistemit të AFP.</b>  <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi dhe roli i AFP.</li> <li>• Struktura e sistemit arsimor në Shqipëri.</li> <li>• Roli dhe veçoritë e arsimit dhe formimit profesional</li> <li>• Format dhe modelet e AFP.</li> <li>• AFP me bazë shkollës dhe AFP me bazë ndërmarrjen (sistemi dual).</li> <li>• Qëllimi dhe veçoritë e arsimit profesional në Shqipëri.</li> </ul>	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Struktura e arsimit profesional në Shqipëri.</li> <li>• Nivelet, drejtimet dhe profilet e arsimit profesional në Shqipëri.</li> <li>• Qëllimi dhe veçoritë e formimit profesional në Shqipëri.</li> <li>• Prirjet e zhvillimit të AFP.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me sistemin e AFP në Shqipëri.</li> <li>○ Diskutime për aspekte të ndryshme të sistemit të AFP.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblendës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<b>RM3</b>	<p><b>Pjesmarrësi analizon konceptet bazë të AFP të bazuar te kompetencat.</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Profesionet dhe klasifikimi i tyre.</li> <li>• Kualifikimet, kualifikimet profesionale dhe klasifikimi i tyre.</li> <li>• Korniza Evropiane dhe Korniza Shqiptare e Kualifikimeve.</li> <li>• Kualifikimet formale, joformale dhe informale.</li> <li>• Kualifikimet profesionale në Shqipëri.</li> <li>• Tregu i punës dhe tregu i kualifikimeve.</li> <li>• Kompetenca dhe kompetenca profesionale.</li> <li>• Përbërja dhe llojet e kompetencave profesionale.</li> <li>• Veçoritë e AFP të bazuar te kompetencat e punës.</li> <li>• Lidhja e AFP me botën e punës.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me konceptet e AFP të bazuar te kompetencat.</li> <li>○ Diskutime për konceptet bazë të AFP të bazuar te kompetencat.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe me shkrim.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblendës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<b>RM4</b>	<p><b>Pjesmarrësi përshkruan kuadrin ligjor dhe institucional të AFP në Shqipëri.</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ligjet bazë në të cilat mbështetet struktura dhe funksionimi i sistemit të AFP në Shqipëri.</li> <li>• Aktet nënligjore kryesore për sektorin e AFP.</li> <li>• Institucionet qendrore dhe mbështetëse të AFP në Shqipëri.</li> <li>• Shkollat profesionale publike dhe jopublike.</li> <li>• Qendrat e formimit profesional publik dhe jopublik.</li> </ul>



- Dokumentacioni themelor në ofruesit e AFP në Shqipëri.
- Kuagri ligjor dhe institucional i partneritetit social në AFP.

***Udhëzime për realizimin:***

- Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*.
- Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me kuadrin ligjor dhe institucional të AFP në Shqipëri.
- Diskutime për aspekte të ndryshme të kuadrit ligjor dhe institucional të AFP.
- Vizitë studimore në një ofrues të AFP.
- Vlerësimi i vazhduar me gojë.
- Vlerësimi i përmblendës me test teorik me shkrim.
- Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë

## 2. Moduli “Hyrje në psikologjinë e të nxënit”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe Kodi i Modullit</b>	<b>HYRJE NË PSIKOLOGJINË E TË NXËNIT</b>	<b>M-27-1047-14</b>
<b>Emërtimi dhe Niveli i Kualifikimit</b>	<b>Instruktor në Arsimin dhe Formimin Profesional</b>	<b>Niveli V i KSHK</b>
<b>Kohëzgjatja e Modullit</b>	<b>30 orë mësimore</b>	
<b>Rezultatet e të Mësuarit (RM)</b>	<b>RM1:</b> Pjesmarrësi analizon aspektet psikologjike të të nxënit <b>RM2:</b> Pjesmarrësi analizon veçoritë e pedagogjisë dhe të andragogjisë <b>RM3:</b> Pjesmarrësi analizon stilet e të nxënit <b>RM4:</b> Pjesmarrësi analizon aspektet socio-kulturore të të nxënit	
<b>RM1</b>	<b>Pjesmarrësi analizon aspektet psikologjike të të nxënit</b> <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Proceset fiziologjike të të nxënit</li> <li>• Memoria dhe struktura e njohurisë.</li> <li>• Llojet e memories dhe faktorët që ndikojnë në memorizim:               <ul style="list-style-type: none"> <li>- memoria afatshkurtër</li> <li>- memoria e punës</li> <li>- memoria afatgjatë</li> <li>- memoria semantike (me bazë interesin)</li> </ul> </li> <li>• Proceset rregullatore që influencojnë të nxënit</li> <li>• Rëndësia e njohurisë paraprake në të mësuarit e njohurive të reja</li> <li>• Emocionet dhe të nxënit</li> <li>• Motivimi</li> <li>• Stresi dhe të nxënit</li> <li>• Zgjidhja e problemeve dhe arsyetimi.</li> <li>• Të mësuarit aktiv</li> </ul> <b>Udhëzime për realizimin:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj dhe me pamje në videoprojektor</li> <li>○ Ndarje në grupe të vogla për studime rasti të përbashkëta</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me anë të studimit të rastit</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>	
<b>RM2</b>	<b>Pjesmarrësi analizon veçoritë e pedagogjisë dhe të andragogjisë</b> <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi për pedagogjinë.</li> <li>• Bazat pedagogjike të të nxënit</li> </ul>	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hyrje në andragogji – si mësojnë të rriturit</li> <li>• Dallimi i modeleve të informacionit</li> <li>• Dallimet midis nxënësit të ri dhe kursantit të rritur</li> <li>• Veçoritë e të nxënit të kursantëve</li> </ul> <p><b><i>Udhëzime për realizimin:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj dhe me pamje në videoprojektor</li> <li>○ Ndarje në grupe të vogla për studime rasti të përbashkëta</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me anë të studimit të rastit</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<p><b>RM3</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi analizon stilet e të nxënit.</b></p> <p><b><i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stilet bazë të të nxënit.</li> <li>• Stili vizual i të nxënit, veçoritë e tij</li> <li>• Stili auditiv i të nxënit, veçoritë e tij</li> <li>• Stili kinestetik i të nxënit, veçoritë e tij</li> <li>• Karakteristikat e stileve të të nxënit: <ul style="list-style-type: none"> <li>- karakteristikat kognitive</li> <li>- karakteristikat afektive</li> <li>- karakteristikat biheviore</li> </ul> </li> <li>• Të nxënit me nevoja të veçanta</li> <li>• Modelet biheviore (të lindura dhe neutrale) të stileve të të nxënit</li> <li>• Modelet kognitive të të nxënit</li> <li>• Inteligjencat e shumëfishta</li> <li>• Të nxënit, vetëvlerësimi dhe qasja pozitive ndaj jetës</li> <li>• Përdorimi i strategjive të mësimdhënies për akomodimin e stileve të ndryshme të të nxënit.</li> <li>• Individualizimi i procesit mësimor</li> </ul> <p><b><i>Udhëzime për realizimin:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj</li> <li>○ Ndarje në grupe të vogla për studime rasti të përbashkëta, referuar stileve të ndryshme të të nxënit.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar gjatë diskutimeve e me anë të studimit të rastit</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë</li> </ul>
<p><b>RM4</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi analizon aspektet socio-kulturore të të nxënit:</b></p> <p><b><i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të nxënit në kontekstin kulturor: <ul style="list-style-type: none"> <li>- të nxënit e individit dhe familja</li> <li>- të nxënit e individit dhe shoqëria</li> </ul> </li> <li>• Të nxënëtit në kontekstin social:</li> </ul>

- të nxënit e individit dhe sistemi i edukimit/formimit
- pritshmërinë ndaj nxënësit
- edukimi gjinor
- Të nxënit si proces holistik dhe ndërveprues mes individit e shoqërisë:
  - karakteristikat e nxënësit (njohuritë ekzistuese, aftësitë, motivimi, qëndrimi dhe stili i të nxënit) në AFP
  - korrektimi i njohurive paraprake dhe aftësive specifike për të siguruar proces të qëndrueshëm të të nxënit

***Udhëzime për realizimin:***

- Shpjegim gojor i ilustruar me shembuj.
- Bashkëbisedim.
- Ndarje në grupe të vogla për studime rasti të përbashkëta, referuar aspekteve socio-kulturore të të nxënit.
- Vlerësimi i vazhduar gjatë diskutimeve e me anë të studimit të rastit
- Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.
- Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë

### 3. Moduli “Kurrikula në AFP”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe Kodi i Modurit</b>	<b>KURRIKULA NË AFP</b>	<b>M-27-1048-14</b>
<b>Emërtimi dhe Niveli i Kualifikimit</b>	<b>Instruktur në Arsimin dhe Formimin Profesional</b>	<b>Niveli V i KSHK</b>
<b>Kohëzgjatja e Modurit</b>	<b>60 orë mësimore</b>	
<b>Rezultatet e të Mësuarit (RM)</b>	<p><b>RM1:</b> Pjesmarrësi analizon konceptin e kurrikulës dhe modelet kurrikulare</p> <p><b>RM2:</b> Pjesmarrësi analizon veçoritë e kurrikulës së AFP të bazuar te kompetencat e punës.</p> <p><b>RM3:</b> Pjesmarrësi analizon elementet kurrikulare</p> <p><b>RM4:</b> Pjesmarrësi harton dokumente kurrikulare që lidhen me mësimin në AFP.</p>	
<b>RM1</b>	<p><b>Pjesmarrësi analizon konceptin e kurrikulës dhe modelet kurrikulare</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi për kurrikulën.</li> <li>• Llojet e kurrikulave (e shkruar, e fshehtë, e zbatuar).</li> <li>• Modelet strukturore të kurrikulës: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kurrikula me strukturë tematike-lëndore;</li> <li>- kurrikula me strukturë modulare;</li> <li>- kurrikula me strukturë projektesh mësimore;</li> </ul> </li> <li>• Nivelet e hartimit, miratimit dhe të zbatimit të kurrikulës.</li> <li>• Modelet e kurrikulave të AP në Shqipëri.</li> <li>• Modelet e kurrikulave të FP në Shqipëri</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Ilustrime me formate të modeleve strukturore kurrikulare dhe formate të dokumenteve kurrikulare të AFP në Shqipëri.</li> <li>○ Detyrë për mbledhje informacioni në lidhje me modelet e kurrikulave.</li> <li>○ Studime rasti në grupe, për strukturat e ndryshme të kurrikulave të AFP në Shqipëri.</li> <li>○ Diskutime për konceptin dhe strukturën e kurrikulave të AFP.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë, nëpërmjet detyrave dhe studimeve të rastit.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblidhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë</li> </ul>	

<p><b>RM2</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi analizon veçoritë e kurrikulës së AFP të bazuar te kompetencat e punës.</b>  <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Veçoritë e kurrikulës së AFP: <ul style="list-style-type: none"> <li>- orientimi nga nevoja për punësim;</li> <li>- orientimi nga kompetenca e punës;</li> <li>- orientimi nga praktika profesionale;</li> <li>- mbështetja në standardet profesionale;</li> <li>- lidhja me biznesin;</li> <li>- fleksibiliteti dhe përshtatja me ndryshimet e nevojave;</li> <li>- pasqyrimi i niveleve dhe drejtimeve profesionale;</li> <li>- nevoja për mjedise dhe mjete pune.</li> </ul> </li> <li>• Shembuj kurrikulash të bazuara te kompetencat e punës.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Ilustrime me formate të kurrikulave të AFP të bazuara te kompetencat e punës.</li> <li>○ Detyrë për mbledhje informacioni në lidhje me kurrikulat e AFP të bazuara te kompetencat.</li> <li>○ Diskutime për veçoritë e kurrikulave të AFP të bazuara te kompetencat.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblendës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<p><b>RM3</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi analizon elementet kurrikulare.</b>  <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Elementet e kurrikulave të AFP.</li> <li>• Qëllimet mësimore.</li> <li>• Përmbajtjet mësimore.</li> <li>• Format dhe metodat mësimore.</li> <li>• Metodot dhe instrumentet e vlerësimit.</li> <li>• Mjedisi, mediet dhe materialet mësimore.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Ilustrime me shembuj të elementeve kurrikulare.</li> <li>○ Detyrë për mbledhje informacioni në lidhje me elementet kurrikulare.</li> <li>○ Diskutime për aspekte të ndryshme të elementeve kurrikulare.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblendës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<p><b>RM4</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi harton dokumente kurrikulare që lidhen me mësimin në AFP.</b></p>

***Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:***

- Struktura dhe rubrikat e “kurrikulës në nivel shkolle/qendre”.
- Analiza e “kurrikulës qendrore”.
- Hartimi i programit për mësimin e njohurive teorike.
- Hartimi i programit për mësimin e shprehive praktike.
- Hartimi i “ditarit” për seanca mësimore teorike dhe praktike.

***Udhëzime për realizimin:***

- Ilustrime me shembuj të strukturës së kurrikulave shkollore dhe të kurrikulës qendrore.
- Detyra në grupe për hartimin e programeve shkollore dhe ditarit.
- Prezantime të detyrave dhe diskutime në lidhje me to
- Vlerësimi i vazhduar me gojë
- Vlerësimi përmblendës nëpërmjet detyrave.
- Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.

#### 4. Moduli “Bazat e procesit mësimor në AFP”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe Kodi i Modullit</b>	<b>BAZAT E PROCESIT MESIMOR NË AFP</b>	<b>M-27-1049-14</b>
<b>Emërtimi dhe Niveli i Kualifikimit</b>	<b>Instruktur në Arsimin dhe Formimin Profesional</b>	<b>Niveli V i KSHK</b>
<b>Kohëzgjatja e Modullit</b>	<b>90 orë mësimore</b>	
<b>Rezultatet e të Mësuarit (RM)</b>	<p><b>RM1:</b> Pjesmarrësi analizon parimet bazë të didaktikës në AFP.</p> <p><b>RM2:</b> Pjesmarrësi analizon veçoritë e mësimit të njohurive</p> <p><b>RM3:</b> Pjesmarrësi analizon veçoritë e mësimit të shprehive të punës</p> <p><b>RM4:</b> Pjesmarrësi analizon veçoritë e zhvillimit të qëndrimeve.</p> <p><b>RM5:</b> Pjesmarrësi analizon veçoritë e komunikimit në procesin mësimor.</p>	
<b>RM1</b>	<p><b>Pjesmarrësi analizon parimet bazë të didaktikës në AFP</b></p> <p><i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi për parimet didaktike.</li> <li>• Rëndësia e zbatimit të parimeve didaktike në procesin mësimor.</li> <li>• Karakteri shkencor i të mësuarit</li> <li>• Karakteri edukues dhe zhvillues i të mësuarit</li> <li>• Lidhja e teorisë me praktikën</li> <li>• Konkretizimi i mësimit</li> <li>• Karakteri sistematik dhe gradual i të mësuarit</li> <li>• Karakteri i vetëdijshëm dhe aktiv (veprues) i të mësuarit</li> <li>• Përshtatja e të mësuarit ndaj nivelit të zhvillimit të nxënësve dhe veçorive moshore individuale të tyre</li> <li>• Veçoritë e zbatimit të parimeve didaktike në AFP.</li> </ul> <p><i>Udhëzime për realizimin:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me parimet didaktike.</li> <li>○ Diskutime për zbatimin e parimeve didaktike në procesin mësimor.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>	
<b>RM2</b>	<p><b>Pjesmarrësi analizon veçoritë e mësimit të njohurive.</b></p> <p><i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi dhe llojet e njohurive.</li> <li>• Veçoritë e mësimit të fakteve.</li> <li>• Veçoritë e mësimit të koncepteve.</li> </ul>	



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Veçoritë e mësimit të parimeve.</li> <li>• Veçoritë e mësimit të strukturave.</li> <li>• Veçoritë e mësimit të procedurave.</li> <li>• Fazat e procesit mësimor për mësimin e njohurive.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Prezantime në video për fazat e procesit mësimor për mësimin e njohurive.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me llojet e njohurive.</li> <li>○ Diskutime për veçoritë e mësimit të njohurive.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> <li>○ Vizita në mjedise mësimore ku mësohen njohuritë.</li> </ul>
<p><b>RM3</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi analizon veçoritë e mësimit të shprehive të punës.</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi dhe llojet e shprehive.</li> <li>• Veçoritë e shprehive të punës.</li> <li>• Fazat e procesit mësimor për mësimin e shprehive të punës: <ul style="list-style-type: none"> <li>- shpjegimi i shprehisë;</li> <li>- demonstrimi i shprehisë nga instruktori;</li> <li>- praktikimi nën mbikëqyrje i nxënësve dhe kursantëve;</li> <li>- praktikimi i pavarur i nxënësve dhe kursantëve.</li> </ul> </li> <li>• Praktikimi i nxënësve dhe kursantëve në mjedise reale pune (biznese)</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Prezantime në video për fazat e procesit mësimor për mësimin e shprehive të punës.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me mësimin e shprehive.</li> <li>○ Diskutime për veçoritë e mësimit të shprehive.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> <li>○ Vizita në mjedise mësimore ku mësohen shprehitë.</li> </ul>
<p><b>RM4</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi analizon veçoritë e zhvillimit të qëndrimeve.</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi dhe llojet e qëndrimeve.</li> <li>• Veçoritë e zhvillimit të qëndrimeve për punë në grupe.</li> <li>• Veçoritë e zhvillimit të qëndrimit pozitiv ndaj punës dhe karrierës.</li> <li>• Veçoritë e zhvillimit të aftësive komunikuese.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Veçoritë e zhvillimit të aftësive për zgjidhje problemesh</li> <li>• Veçoritë e zhvillimit të sjelljes sipërmarrëse.</li> <li>• Veçoritë e zhvillimit të sjelljes së orientuar nga klienti.</li> <li>• Veçoritë e zhvillimit të sjelljes për zhvillimin e qëndrueshëm</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me zhvillimin e qëndrimeve.</li> <li>○ Prezantime të detyrave dhe diskutime për veçoritë e zhvillimit të qëndrimeve.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<b>RM5</b>	<p><b>Pjesmarrësi analizon veçoritë e komunikimit në procesin mësimor.</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia dhe kuptimi për komunikimin në procesin mësimor.</li> <li>• Të dëgjuarit dhe përcjellja e mesazhit gjatë komunikimit</li> <li>• Llojet e komunikimit, komunikimi verbal dhe joverbal.</li> <li>• Komunikimi dhe motivimi i nxënësve.</li> <li>• Menaxhimi i stresit në procesin mësimor.</li> <li>• Zgjidhja e konflikteve në procesin mësimor.</li> <li>• Standardet bazë të mësuesit në lidhje me komunikimin</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Lojë me role për aspekte të komunikimit.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me komunikimin dhe menaxhimin e situatave të ndryshme në procesin mësimor.</li> <li>○ Diskutime për veçoritë e komunikimit në procesin mësimor.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave e lojës me role.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>

## 5. Moduli “Vlerësimi i nxënësve dhe kursantëve në AFP”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe Kodi i Modullit</b>	<b>VLERËSIMI I NXËNËSVE DHE KURSANTËVE NË AFP</b>	<b>M-27-1050-14</b>
<b>Emërtimi dhe Niveli i Kualifikimit</b>	<b>Instruktor në Arsimin dhe Formimin Profesional</b>	<b>Niveli V i KSHK</b>
<b>Kohëzgjatja e Modullit</b>	<b>90 orë mësimore</b>	
<b>Rezultatet e të Mësuarit (RM)</b>	<p><b>RM1:</b> Pjesmarrësi analizon kuptimin, parimet, llojet dhe veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP</p> <p><b>RM2:</b> Pjesmarrësi përshkruan format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP</p> <p><b>RM3:</b> Pjesmarrësi përgatit instrumente për vlerësimin e njohurive</p> <p><b>RM4:</b> Pjesmarrësi përgatit instrumente për vlerësimin e shprehive dhe kompetencave të punës.</p>	
<b>RM1</b>	<p><b>Pjesmarrësi analizon kuptimin, parimet, llojet dhe veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi për vlerësimin e nxënësve/kursantëve</li> <li>• Parimet themelore të vlerësimit të nxënësve/kursantëve: <ul style="list-style-type: none"> <li>- objektiviteti</li> <li>- besueshmëria.</li> <li>- vleftshmëria.</li> <li>- prakticiteti.</li> </ul> </li> <li>• Llojet e vlerësimeve të nxënësve/kursantëve: <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerësim paraprak</li> <li>- vlerësimi vazhduar (gjatë procesit mësimor).</li> <li>- vlerësim përmbledhës (përfundimtar)</li> <li>- vlerësim diagnostikues.</li> <li>- vlerësimi i bazuar në kriteret (standardet)</li> <li>- vlerësimi i bazuar në normën (renditjen)</li> <li>- vlerësimi i njohurive.</li> <li>- vlerësimi i shprehive praktike.</li> <li>- vlerësimi i qëndrimeve.</li> </ul> </li> <li>• Veçoritë e vlerësimit të nxënësve/kursantëve në AFP</li> <li>• Dhënia e rezultateve të vlerësimit (skemat e notimit).</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të llojeve të ndryshme të vlerësimeve.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me parimet dhe llojet e vlerësimeve.</li> <li>○ Prezantime të detyrave dhe diskutime për veçoritë e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP.</li> </ul>	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<p><b>RM2</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi përshkruan format, metodat dhe instrumentet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve në AFP.</b>  <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Format dhe metodat e vlerësimit të nxënësve/kursantëve.</li> <li>• Kuptimi për instrumentet e vlerësimit të nxënësve/kursantëve.</li> <li>• Instrumentet për vlerësimin e njohurive: <ul style="list-style-type: none"> <li>- pyetje-përgjigje me gojë (të hapura dhe të mbyllura)</li> <li>- pyetje-përgjigje me shkrim (të hapura dhe të mbyllura)</li> <li>- testet teorike dhe rregullat e përgatitjes së tyre</li> </ul> </li> <li>• Instrumentet për vlerësimin e shprehive: <ul style="list-style-type: none"> <li>- listat e kontrollit për vlerësimin e procesit të punës</li> <li>- listat e kontrollit për vlerësimin e produktit të punës</li> </ul> </li> <li>• Instrumentet për vlerësimin e integruar-Portofoli (rubrikat e vlerësimit, detyrat, projektet).</li> <li>• Instrumentet për vlerësimin e qëndrimeve (sjelljeve).</li> <li>• Kriteret e përzgjedhjes së instrumenteve të vlerësimit të nxënësve/kursantëve.</li> <li>• Provimet përfundimtare teorike dhe praktike, administrimi i tyre.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të instrumenteve të vlerësimit të llojeve të ndryshme.</li> <li>○ Detyra në grupe për mbledhje informacioni në lidhje me format, metodat dhe instrumentet e vlerësimeve.</li> <li>○ Prezantime të detyrave dhe diskutime për format, metodat dhe instrumentet e vlerësimeve.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> <li>○ Vizita në mjedise mësimore ku kryhen vlerësime të nxënësve dhe kursantëve.</li> </ul>
<p><b>RM3</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi përgatit instrumente për vlerësimin e njohurive.</b>  <b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgatitja e pyetjeve me përgjigje me gojë (të hapura dhe të mbyllura) për vlerësimin e njohurive</li> <li>• Përgatitja e instrumenteve për vlerësimin e njohurive, me shkrim: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e pyetjeve me përgjigje të hapura (ese)</li> <li>- Përgatitja e pyetjeve me përgjigje të mbyllura: <ul style="list-style-type: none"> <li>- pyetje me plotësim të pjesës që mungon;</li> <li>- pyetje me PO ose JO;</li> <li>- pyetje me alternativa;</li> <li>- pyetje me kombinim.</li> </ul> </li> </ul> </li> <li>• Përgatitja e testeve komplekse me shkrim.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shembuj të instrumenteve të vlerësimit të njohurive, me shkrim.</li> <li>○ Lojë me role për praktikimin e vlerësimit të njohurive, me gojë.</li> <li>○ Detyra individuale për përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit të njohurive, me shkrim.</li> <li>○ Prezantime të detyrave dhe diskutime në lidhje me instrumentet e vlerësimit të njohurive.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave dhe lojës me role.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> <li>○ Vizita në mjedise mësimore ku kryhen vlerësime të njohurive të nxënësve dhe kursantëve.</li> </ul>
<p><b>RM4</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi përgatit instrumente për vlerësimin e shprehive dhe kompetencave të punës.</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Përgatitja e listave të kontrollit për vlerësimin e procesit të punës.</li> <li>● Përgatitja e listave të kontrollit për vlerësimin e produktit të punës</li> <li>● Përgatitja e listave të kontrollit komplekse.</li> <li>● Përgatitja e rubrikave të vlerësimit të nxënësve/kursantëve.</li> <li>● Përgatitja e detyrave praktike për vlerësimin e nxënësve/kursantëve</li> <li>● Përgatitja e projekteve praktike për vlerësimin e nxënësve/kursantëve</li> <li>● Konceptimi i portofoleve për vlerësimin e nxënësve/kursantëve.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të instrumenteve të vlerësimit të shprehive (lista kontrolli).</li> <li>○ Detyra individuale për përgatitjen e listave të kontrollit, projekteve dhe portofoleve vlerësuese.</li> <li>○ Lojë me role për praktikimin e vlerësimit të shprehive me lista kontrolli</li> <li>○ Prezantime të detyrave dhe diskutime në lidhje me instrumentet e vlerësimit të shprehive.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave e lojës me role.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> <li>○ Vizita në mjedise mësimore ku kryhen vlerësime të shprehive të nxënësve dhe kursantëve</li> </ul>

## 6. Moduli “Planifikimi dhe realizimi i mësimit në AFP”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe Kodi i Modullit</b>	<b>PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I MËSIMIT NË AFP</b>	<b>M-27-1051-14</b>
<b>Emërtimi dhe Niveli i Kualifikimit</b>	<b>Instruktor në Arsimin dhe Formimin Profesional</b>	<b>Niveli V i KSHK</b>
<b>Kohëzgjatja e Modullit</b>	<b>240 orë mësimore</b>	
<b>Rezultatet e të Mësuarit (RM)</b>	<p><b>RM1:</b> Pjesmarrësi përshkruan parimet bazë dhe fazat e mësimit në AFP</p> <p><b>RM2:</b> Pjesmarrësi harton objektivat mësimore</p> <p><b>RM3:</b> Pjesmarrësi përcakton përmbajtjet mësimore</p> <p><b>RM4:</b> Pjesmarrësi përzgjedh metodat mësimore</p> <p><b>RM5:</b> Pjesmarrësi përgatit instrumentet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve</p> <p><b>RM6:</b> Pjesmarrësi përgatit dhe përdor mjedisin, mediet dhe materialet mësimore</p> <p><b>RM7:</b> Pjesmarrësi planifikon dhe realizon mësimet teorike</p> <p><b>RM8:</b> Pjesmarrësi planifikon dhe realizon mësimet praktike</p>	
<b>RM1</b>	<p><b>Pjesmarrësi përshkruan parimet bazë dhe fazat e mësimit në AFP</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Parimet e planifikimit të mësimit në AFP.</li> <li>• Analiza e përmbajtjeve mësimore</li> <li>• Analiza e numrit të nxënësve/kursantëve</li> <li>• Analiza e kohës në dispozicion</li> <li>• Analiza e kushteve mësimore: mjedisve, mjeteve, pajisjeve dhe materialeve në dispozicion.</li> <li>• Fazat e mësimit me fokus teorinë</li> <li>• Fazat e mësimit me fokus praktikën</li> <li>• Të nxënit jashtë mjedisit të shkollës/qendrës (në mjediset reale të punës).</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të analizës së faktorëve për planifikimin e mësimit në AFP.</li> <li>○ Studime rasti në grupe, për planifikimin e fazave të mësimit.</li> <li>○ Prezantime të studimeve të rastit dhe diskutime në lidhje me planifikimin e fazave të mësimit.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet studimeve të rastit.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>	
<b>RM2</b>	<p><b>Pjesmarrësi harton objektivat mësimore</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p>	

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi dhe hierarkia e objektivave mësimore dhe veçoritë në AFP</li> <li>• Kriteret e hartimit të objektivave mësimore bazuar në synimet e lëndës dhe RM-të e modulit.</li> <li>• Struktura e një objektivi mësimor specifik</li> <li>• Kriteret për përzgjedhjen dhe renditjen e objektivave mësimore.</li> <li>• Përcaktimi dhe formulimi i objektivave mësimore që i referohen njohurive</li> <li>• Përcaktimi dhe formulimi i objektivave mësimore që i referohen shkathtësive.</li> <li>• Përcaktimi dhe formulimi i objektivave mësimore që i referohen qëndrimeve.</li> <li>• Prezantimi dhe diskutimi i objektivave të hartuara.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të formulimit të objektivave mësimore.</li> <li>○ Detyra individuale për hartimin e objektivave mësimore.</li> <li>○ Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me hartimin e objektivave mësimore.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<b>RM3</b>	<p><b>Pjesmarrësi përcakton përmbajtjet mësimore</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lidhja mes përmbajtjes së punës dhe përmbajtjes mësimore.</li> <li>• Përmbajtja mësimore dhe kualifikimet profesionale</li> <li>• Çështjet (temat) mësimore teorike</li> <li>• Veprimtaritë mësimore në AFP</li> <li>• Kriteret e përzgjedhjes së përmbajtjes</li> <li>• Hartimi i çështjeve mësimore që i referohen njohurive</li> <li>• Hartimi i veprimtarive mësimore që i referohen shprehive</li> <li>• Prezantimi dhe diskutimi i përmbajtjeve të përzgjedhura.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore teorike (çështjeve) dhe praktike (veprimtarive).</li> <li>○ Detyra individuale për përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore.</li> <li>○ Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë</li> </ul>
<b>RM4</b>	<p><b>Pjesmarrësi përzgjedh metodat mësimore</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kuptimi për “metodën mësimore”</li> <li>• Veçoritë e metodave mësimore në AFP</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kriteret për përzgjedhjen e metodave mësimore në AFP.</li> <li>• Përzgjedhja e metodave mësimore për mësimin e orientuar nga teoria.</li> <li>• Përzgjedhja e metodave mësimore për mësimin e orientuar nga praktika.</li> <li>• Përzgjedhja e metodave që zhvillojnë qëndrimet e nxënësve dhe kursantëve.</li> <li>• Prezantimi dhe diskutimi për metodat e përzgjedhura</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të përzgjedhjes së metodave për mësimin teorik dhe mësimin praktik.</li> <li>○ Detyra individuale për përzgjedhjen e metodave mësimore.</li> <li>○ Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me përzgjedhjen e metodave mësimore.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblidhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<p><b>RM5</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi përgatit instrumentet e vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve.</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e kompetencave, synimeve dhe RM-ve të kurrikulës</li> <li>• Kthimi i objektivave të kurrikulës në objektiva të vlerësimit</li> <li>• Hartimi i instrumenteve për vlerësimin e aspekteve teorike</li> <li>• Hartimi i instrumenteve për vlerësimin e aspekteve praktike</li> <li>• Hartimi i rubrikës së vlerësimit.</li> <li>• Prezantimi dhe diskutimi i instrumenteve të vlerësimit.</li> </ul> <p><b>Udhëzime për realizimin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në <i>powerpoint</i>.</li> <li>○ Shembuj të instrumenteve dhe rubrikave të vlerësimit të nxënësve dhe kursantëve.</li> <li>○ Detyra individuale për përgatitjen e instrumenteve të vlerësimit.</li> <li>○ Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me instrumentet e vlerësimit të përgatitura.</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar me gojë dhe nëpërmjet detyrave.</li> <li>○ Vlerësimi i përmblidhës me test teorik me shkrim.</li> <li>○ Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.</li> </ul>
<p><b>RM6</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi përgatit dhe përdor mjedisin, mediet dhe materialet mësimore</b></p> <p><b>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëllimi dhe rëndësia e parapërgatitjes së mjedisit, medieve dhe materialeve mësimore.</li> <li>• Përgatitja e mjedisit mësimor dhe mjeteve mësimore: <ul style="list-style-type: none"> <li>- kushtet dhe kriteret për mjedisin mësimor (hapësirat, ndriçimi, ajrimi, pajisjet).</li> </ul> </li> </ul>



- siguria, higjiena dhe mirëmbajtja e mjedisit mësimor
- planifikimi i mjedisit për mësimin teorik
- planifikimi i mjedisit për mësimin praktik.
- planifikimi i mjeteve mësimore
- prezantimi dhe diskutimi.
- Përgatitja e medieve mësimore:
  - klasifikimi i medieve
  - kushtet dhe kriteret për përdorimin e medieve mësimore.
  - përdorimi i dërrasës së zezë
  - përdorimi i flipçartit
  - përdorimi i pinbordit
  - përdorimi i projektorit elektronik
  - planifikimi i medieve për mësimin teorik
  - planifikimi i mësimin për mësimin praktik
  - prezantimi dhe diskutimi.
- Përgatitja e materialeve mësimore:
  - llojet e materialeve mësimore.
  - kushtet dhe kriteret për përgatitjen e materialeve mësimore
  - përgatitja e materialeve të shkruara për nxënësit
  - përgatitja e prezantimeve
  - përgatitja e detyrave, projekteve, eseve.
  - përgatitja e portofolit të të nxënit
  - prezantimi dhe diskutimi.
- Krijimi i lidhjeve me biznesin rajonal dhe organizimi i praktikës së nxënësve dhe kursantëve në mjedise reale pune.

***Udhëzime për realizimin:***

- Shpjegim gojor i ilustruar me prezantime në *powerpoint*.
- Shembuj të organizimit të mjediseve mësimore dhe të pajisjes së tyre me medie dhe mjete mësimore.
- Shembuj të materialeve mësimore të shkruara.
- Detyra në grup për organizimin e mjediseve mësimore teorike dhe praktike.
- Detyra individuale për përgatitjen e materialeve mësimore të shkruara
- Prezantime të detyrave të kryera dhe diskutime në lidhje me to.
- Demonstrime individuale të përdorimit të medieve mësimore (dërrasë e zezë, flipçart, projektor elektronik, pinbord etj.).
- Vlerësimi i vazhduar me gojë, si dhe nëpërmjet detyrave e demonstrimeve.
- Vlerësimi i përmbledhës me test teorik me shkrim.
- Mësimi zhvillohet kryesisht në klasë.
- Vizita në ofrues të AFP si dhe në biznese lokale.

<p><b>RM7</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi planifikon dhe realizon mësimet teorike</b></p> <p><b><i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedhja e një njësie mësimore teorike nga çdo pjesmarrës.</li> <li>• Planifikimi i veprimtarive mësimore për njohuritë dhe lidhja me kompetencën.</li> <li>• Përgatitja e “ditarit” për njësinë mësimore teorike.</li> <li>• Përgatitja e materialeve mbështetëse për mësimin teorik dhe instrumenteve të vlerësimit me shkrim.</li> <li>• Përgatitja e mjedisit dhe medieve didaktike për realizimin e mësimin teorik.</li> <li>• Realizimi i hyrjes së mësimin</li> <li>• Realizimi i shpjegimit të njohurive teorike.</li> <li>• Realizimi i diskutimit, punëve në grup, punëve të pavarura.</li> <li>• Dhënia e detyrave të klasës dhe të shtëpisë</li> <li>• Realizimi i vlerësimit të shkallës së përvetësimit të njohurive.</li> <li>• Përmbyllja e mësimin teorik</li> </ul> <p><b><i>Udhëzime për realizimin:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Dhënia e detyrës për çdo pjesmarrës.</li> <li>○ Krijimi i kushteve të përshtatshme që çdo pjesmarrës të realizojë njësi mësimore teorike.</li> <li>○ Lojë me role për të simuluar realizimin e fazave të mësimin teorik.</li> <li>○ Realizimi nga çdo pjesmarrës i njëjësive mësimore teorike të simuluar.</li> <li>○ Diskutime në lidhje me mësimet teorike të realizuara nga pjesmarrësit</li> <li>○ Vlerësimi i vazhduar dhe përmbledhës i çdo pjesmarrësi i bazuar në dokumentacionin e përgatitur dhe në performancën e realizimit të mësimin teorik.</li> <li>○ Mësimet teorike zhvillohen në klasa mësimore të pajisura me mjetet e duhura për mësimin teorik.</li> <li>○ Vizita në ofrues të AFP për të vëzhguar njësi mësimore teorike.</li> </ul>
<p><b>RM8</b></p>	<p><b>Pjesmarrësi planifikon dhe realizon mësimet praktike.</b></p> <p><b><i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedhja e një njësie mësimore praktike.</li> <li>• Planifikimi i veprimtarive mësimore praktike dhe lidhja me njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet.</li> <li>• Përgatitja e “ditarit” për njësinë mësimore praktike.</li> <li>• Përgatitja e udhëzuesit të punës dhe listës së kontrollit.</li> <li>• Përgatitja e mjedisit të punës, mjeteve dhe materialeve shpenzuese.</li> <li>• Realizimi i hyrjes së mësimin praktik.</li> <li>• Shpjegimi i shprehisë që do të fitohet.</li> <li>• Realizimi i demonstrimit të shprehisë së punës.</li> <li>• Realizimi i praktikës së mbikqyrur.</li> <li>• Realizimi i praktikës së pavarur.</li> </ul>

- Realizimi i vlerësimit të procesit dhe/ose produktit të punës.
- Përmbyllja e mësimit praktik.

***Udhëzime për realizimin:***

- Dhënia e detyrës për çdo pjesmarrës.
- Krijimi i kushteve të përshtatshme që çdo pjesmarrës të realizojë njësi mësimore praktike.
- Lojë me role për të simuluar realizimin e fazave të mësimit praktik.
- Realizimi nga çdo pjesmarrës i njësive mësimore praktike të simuluar.
- Diskutime në lidhje me mësimet praktike të realizuara nga pjesmarrësit.
- Vlerësimi i vazhduar dhe përmbledhës i çdo pjesmarrësi i bazuar në dokumentacionin e përgatitur dhe në performancën e realizimit të mësimit praktik.
- Mësimet praktike zhvillohen në mjedise pune të pajisura me mjetet dhe materialet e duhura për mësimin praktik.
- Vizita në ofrues të AFP për të vëzhguar njësi mësimore praktike.

## **IX. Udhëzime për Praktikën e grupuar në një ofrues të AFP**

- Praktika e grupuar e pjesmarrësve në kualifikimin për “Instruktor në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP)” do të zhvillohet në mjediset mësimore të një ofruesi të AFP (shkollë profesionale ose qendër e formimit profesional, publike ose jo publike).
- Paraprakisht, pjesmarrësi duhet të ketë një kontratë me ofruesin e AFP, ku të garantohet angazhimi i këtij ofruesi për të mundësuar praktikimin e pjesmarrësit në mjediset mësimore përkatëse. Kontrata duhet të garantojë dhe caktimin nga ofruesi të një mësuesi/instruktori në rolin e mentorit, pra përgjegjës për udhëzimin, mbikqyrjen dhe vlerësimin e pjesmarrësit gjatë periudhës së praktikimit.
- Gjatë praktikës së grupuar, pjesmarrësi duhet të realizojë seanca mësimore teorike dhe praktike, fillimisht i udhëzuar dhe i mbikqyrur nga mentori, dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Kohëzgjatja e praktikës së grupuar është 450 orë mësimore (15 javë x 5 ditë/javë x 6 orë/ditë).
- Praktika e grupuar zhvillohet pas përfundimit të procesit mësimor teoriko-praktik nga ofruesi i kualifikimit dhe para provimeve përfundimtare.
- Gjatë praktikës së e grupuar pjesmarrësi duhet të angazhohet në fazat e parashikuara në Modulën 6, pra në planifikimin dhe parapërgatitjen e procesit mësimor, realizimin e mësimeve teorike dhe veçanërisht praktike, vlerësimin e nxënësve/kursantëve dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës.
- Drejtuesit e institucionit ofrues të AFP dhe mentori përkatës duhet të krijojnë kushte që pjesmarrësi të angazhohet në realizimin e seancave mësimore, veçanërisht praktike, në kushte reale. Pjesmarrësi duhet të marrë pjesë aktive edhe në veprimtaritë e tjera që zhvillohen në ofruesin e AFP.
- Gjatë periudhës së praktikës së grupuar, pjesmarrësi harton dhe plotëson një “portofol” si evidencë e veprimtarive të zhvilluara nga ai.
- Vlerësimi i vazhduar i pjesmarrësit gjatë periudhës së praktikës së grupuar kryhet nga mentori nëpërmjet vëzhgimeve të pjesmarrësit dhe vlerësimit të portofolit të tij. Ky vlerësim i dërgohet i dokumentuar ofruesit të kualifikimit për “Instruktor në Arsimin dhe Formimin Profesional”.